



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Hajrulla Çeku, Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Adresa: Sheshi Nena Tereze pa nr., Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Neni 19.3.1 i PFV-ve, pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive të ministrisë. Auditimi ka nxjerrë në pah se në 16 pagesa në total prej 907,355€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së, ndërsa një (1) pagesë në vlerë 15,829€ ishte e regjistruar dy herë. Veç kësaj, ministria vazhdon ta ketë të regjistruar ende si investime në vijim vlerën e pasurisë prej 667,114€, edhe pse projektet kapitale kishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre.

Edhe pasuria jo kapitale (me vlerë nën 1,000€), nuk ishte prezantuar drejtë. Në katër (4) raste, pasuria e blerë në vlerë prej 45,033€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e e-pasurisë. Në një (1) rast pasuria në vlerë prej 14,828€ ishte regjistruar dy herë si dhe regjistri i pasurive nën 1,000€, nuk e kishte të zbritur vlerën e zhvlerësimit të akumuluar.

- A1 Neni 17 i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) nuk prezanton vlerën e saktë të Obligimeve të papaguara në fund të vitit 2020, për faktin se vlera e obligimeve të papaguara të prezantuara në PFV ishte mbivlerësuar për 188,660€.
- C1 Gjatë vitit 2020, thesari përmes vendimeve gjyqësore kishte kryer pagesa në vlerë 33,252€ nga kode jo adekuate, të cilat ishin bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, mirëpo ishin paguar për qëllime të investimeve kapitale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B2 Në shtatë (7) raste në vlerë 40,268€ kishte vonesë në pagesa duke filluar nga 41 deri 153 ditë, pas afatit të lejuar prej 30 ditësh.
- B3 Ministria kishte avanse të hapura në vlerë 38,728€ që nga viti 2010, për të cilat zyrtarët përgjegjës ende nuk kishin sjellur dëshmitë përkatëse për mbylljen dhe arsyetimin e tyre.
- A2 Në katër (4) raste MKRS kishte tejkaluar pozicionet e parapara me kontratë në vlerë prej 16,961€. Ndryshimet e sasive të punëve nga sasitë e përcaktuara në kontratë nuk ishin raportuar nga menaxherët e kontratave. Ndërsa në tri (3) raste, kishte nënshkruar aneks kontrata, duke tejkaluar 10% të vlerës së kontratës.
- B4 Në 16 pagesa me vlerë totale 337,158€ përfituesit e subvencioneve nuk e kishin bërë ende mbylljen e avanseve përkatësisht arsyetimin e shpenzimeve, ashtu siç kërkohet me neni 21 të rregullores 09/2015 për subvencionime në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve, që përfituesit e subvencioneve pas realizimit të projekteve janë të obliguar të bëjnë mbylljen e tyre brenda 30 ditëve me dorëzimin e dëshmimeve të dokumentuara.
- A3 Ministria kishte ekzekutuar tetë (8) pagesa me vlerë totale 274,451€ për federatat e sporteve të Kosovës pavarësisht asaj që federatat ende nuk i kishin arsyetuar në tërësi mjetet e kësteve parapara, ashtu siç përcaktohet në memorandumet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet MKRS dhe federatave të sporteve të Kosovës.
- A4 Gjatë testimit kemi identifikuar se dy OJQ, "Doku Fest" dhe Fondacioni "Lumbardhi" gjatë vitit 2020, kishin përfituar subvencionim të dyfishtë në vlerë prej 19,500€ nga dy departamente brenda ministrisë për të njëjtin projekt.
- B5 Për 30 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrotja civile", MKRS-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të konfirmuar vijueshmërinë në punë. Shpenzimet e pagave gjatë vitit 2020 për të punësuarit e lartë cekur ishin 158,989€.
- A5 MKRS kishte kryer pagesa në vlerë prej 56,575€ për kompensimin e stafit të angazhuar në këshilla drejtuese dhe komisione të ndryshme, në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike i cili ndalon kompensimin shtesë brenda orarit të punës nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik.
- A6 Në tri (3) raste në vlerë 34,974€, kemi vërejtur që ministria në fillim kishte pranuar faturën, pastaj kishte bërë zotimin e mjeteve dhe nxjerrjen e urdhër blerjeve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i MKRS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i MKRS është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (shih Grafikon 1) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive

Gjetja

Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, te neni 6, citon që: çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, pika 3 përcakton se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri.

Pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive në ministri. Auditimi ka nxjerrë në pah se në 16 pagesa në vlerë prej 907,355€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së, ndërsa një (1) pagesë në vlerë 15,829€ ishte regjistruar dy herë. Në anën tjetër, ministria vazhdon t'i ketë të regjistruara ende si investime në vijim vlerën e pasurisë prej 667,114€, edhe pse projektet kapitale kishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre.

Edhe pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€), nuk ishin prezantuar drejtë. Në katër (4) raste, pasuria e blerë në vlerë prej 45,033€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e e-pasurisë, në një (1) rast pasuria në vlerë prej 14,828€ ishte regjistruar dy herë, si dhe regjistri i pasurive nën 1,000€, nuk përmban zhvlerësimin e akumuluar të llogaritur.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë në kryerjen e detyrave nga zyrtarët kompetent.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurive në PVF dhe pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë me rrezikun që pasuritë të humbin apo keqpërdoren.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Shpalosje jo e drejtë e obligimeve të papaguara në PVF

Gjetja

Neni 17 i Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar - përcakton se organizatat buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Neni 17 i PFV-ve nuk prezanton vlerën e saktë të Obligimeve të papaguara në fund të vitit 2020, për faktin se vlera e obligimeve të papaguara të prezantuara në PFV ishte mbivlerësuar për 188,660€. Këto janë vërejtur si në vijim:

- Në pesë raste në vlerë prej 25,150€, obligimet e papaguara ishin prezantuar dy herë;
- Vlera 163,510€ e obligimet të papaguara të prezantuara në PFV në për 16 projekte filmike të financuara nga Qendra Kinematografike e Kosovës, ishin obligime kontraktuese, meqenëse nuk kishte kërkesë për pagesë nga përfituesit.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në përgatitjen, sigurimin dhe analizimin e informacioneve të duhura për prezantim në PFV-ve.

Ndikimi Shpalosja jo e saktë e obligimeve, ka ndikuar në mbivlerësimin e obligimeve dhe prezantimin jo të drejt të informatave për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj që me rastin e përgatitjes së PVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për obligimet e papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare Nr. 01/2013 shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Gjatë vitit 2020, thesari përmes vendimeve gjyqësore kishte kryer pagesa në vlerë 33,252€ nga kode jo adekuate.

Këto ishin nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së investimeve kapitale. Prej tyre, pagesa në vlerë 15,112€ ishte për projektin "Ndërtimi i Pishinës Olimpike" në Prizren ndërsa pagesa në vlerë 18,140€ ishte për projektin "Studimin e Fizibilitetit për Stadiumin Kombëtar të Futbollit" në Drenas.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur në mungesë të mjeteve buxhetore në kodet adekuate.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kodet jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në nënvlerësimin e disa llogarive dhe mbivlerësimin e llogarive tjera, që për efekt kanë paraqitjen e pa saktë të gjendjes së llogarive.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të sigurojë një bashkëpunim efektiv me Ministrinë e Financave për të siguruar që pagesat realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas kërkesave të rregullores në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimi të faturës apo kërkesës për pagim. Ndërsa rregullorja Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 24, paragrafi 1.3, përcakton se të gjitha faturat duhet të protokollohen dhe evidentohen në librin e faturave.

Nga lista e obligimeve të shpalosura në PFV, ne kemi testuar shtatë (7) mostra dhe nga testimi ka rezultuar se faturat me vlerë të përbashkët 40,268€, nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat në pagesa janë duke filluar nga 41 ditë deri 153 ditë.

Ndërsa në tre (3) raste ne kemi identifikuar se faturat në vlerë totale prej 577,935€ nuk ishin evidentuar në librin e protokollit nga ministria. Për më tepër në njërin prej faturave në vlerë prej 576,000€ për Studimin e Fizibilitetit për Stadiumin Kombëtar të Futbollit në Drenas përveç që nuk ishte e protokoluar nuk kishte dëshmi që është pranuar nga ministria meqenëse nuk kishte nënshkrim nga zyrtarët përgjegjës.

Kjo ka ndodhur pasi që MKRS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimi dhe pagesës së faturave, ngase faturat e pranuar nuk protokollohen dhe nuk evidentohen në librin e faturave

Ndikimi

Vonesat në pagesa dhe mos zbatimi i procedurave të kontrollit të me rastin e pranimi të faturave që kanë të bëjnë me protokolimin dhe evidentimin e tyre në librin e faturave, rrit rrezikun e përballjes me drejtësinë përmes vendimeve gjyqësore apo përmbarimore duke krijuar shpenzime shtesë dhe vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare.

Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2004/07 për Shpenzimet e Udhëtimeve Zyrtare, të gjitha avanset duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi.

Në një rast avansi i dhënë për pjesëmarrje në festivalin e Berlinit në vlerë 1,534€, nuk ishte arsyetuar dhe mbyllur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. Mbyllja e tij ishte bërë me 9 muaj vonesë. Për më tepër në ministri kishte avanse të hapura që nga viti 2010 për të cilat zyrtarët përgjegjës ende nuk kishin sjellur dëshmitë përkatëse për mbylljen përkatësisht arsyetimin e tyre. Vlera e avanseve të paarsyetuara deri në fund të vitit 2020 ishte 38,728€.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat që menaxhmenti i ministrisë nuk kishte ndërmarr veprime ligjore ndaj zyrtarëve përfitues për kthimin e mjeteve.

Ndikimi

Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve dhe mos mbyllja e avanseve, rritë rrezikun që paratë publike të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara, rregullat e aplikueshme apo të keqpërdoren.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të ndërmarrë veprimet për të gjitha avanset e pa arsyetura që nga viti 2010 deri në fund të vitit 2019, t'i arsyetojnë dhe mbyllin ato me zyrën e financave. Në rast se nuk i posedojnë dëshmitë e duhura për arsyetimin e tyre, atëherë të kthehen paratë në buxhetin e ministrisë. Në të kundërtën, të ushtrojë padi gjyqësore kundër të gjithë personave për kthimin e këtyre parave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Shpenzime shtesë si pasojë e hartimit të dobët të projekteve dhe specifikimeve teknike

Gjetja

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.19 "Menaxhimi i kontratës është përgjegjësi e menaxherit të projektit, i cili duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë". Tutje LPP neni 35 pika 2.4, thekson që autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës kur punët apo shërbimet e tilla, edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale, janë të domosdoshme për të kompletuar punët, me kusht që vlera e punimeve nuk është më shumë se 10% e vlerës së kontratës origjinale.

Gjatë auditimit ne kemi identifikuar në katër raste se MKRS kishte tejkualuar pozicionet e parapara me kontratë në vlerë prej 16,961€. Ndryshimet e sasive të punëve nga sasitë e përcaktuara në kontratë nuk ishin raportuar nga menaxherët e kontratave. Këto raste janë vërejtur si më poshtë:

- Te kontrata “Kompleksi i Fushave të tenisit” me vlerë 98,891€ - Ferizaj, vlera financiare e tejkualimit të pozicionit ishte 1,530€;
- Te kontrata “Renovimi dhe funksionalizimi i Kullës Isa Kastrati dhe Shtëpive Komunitare në Kamenicë” me vlerë 162,928€ - kemi tejkualim të pozicionit të paraparë me kontratë në vlerë 3,058€;
- Te kontrata “Renovimi i stadiumit Gjakovë” me vlerë 1,056,609€, te pagesa e situacionit në vlerë 50,000€ kemi tejkualim të pozicioneve në vlerë 5,842€; dhe
- Te kontrata “Palestra sportive Skenderaj” me vlerë 651,965€, vlera financiare e tejkualuar në katër pozicione ishte 6,531€.

Po ashtu në tri raste MKRS kishte nënshkruar aneks kontrata duke tejkualuar 10% të vlerës së kontratës. Tejkualimet ishin te kontrata “Hidroizolimi i kulmit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës”, “Intervenimet Emergjente - tek Kulla e Reshat Istrefaj”, dhe “Ndërtimi i Kullës Haxhë (Mustafë) Lajçi”.

Mangësitë e përmendura më lartë kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kushtet në terren, si dhe nga futja e projekteve në ligj të buxhetit, pa ndonjë analizë paraprake të mirëfilltë të projekteve.

Ndikimi

Tejkualimi i pozicioneve mbi sasitë e kontraktuara rrezikon që të mos realizohen pozicionet tjera brenda kontratës, si dhe lidhja e kontratave përtej shumës së lejuar, ndikon në rritje të shpenzimeve përtej buxhetit të planifikuar duke krijuar kosto shtesë deri tek finalizimi i tyre.

Rekomandimi A2

Ministri të siguroj që janë vendosur kontrole adekuate të cilat konfirmojnë saktësinë dhe rregullsinë e implementimit të projekteve në mënyrë që çdo projekt të implementohet sipas kushteve të kontratës. Njëherit të siguroj që kërkesat ligjore lidhur me aneks kontratat aplikohen në mënyrë strikte.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në arsyetimin e subvencione

Gjetja

Ministria me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të kulturës në përgjithësi, përveç tjerash, bënë edhe subvencionimin e projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive, qoftë të entiteteve publike apo atyre jo publike. Subvencionet jepen në formë të avanteve me qëllim që të njëjtat të arsyetohen në fund dhe të mbyllen avancet. Sipas marrëveshjeve të nënshkruara, me rastin e dhënies së subvencioneve, bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara, në afat prej 30 ditësh pas realizimit të aktiviteteve të subvencionuara.

Nga testimet e auditimit ka rezultuar se në 16 raste të subvencionimeve në vlerë 337,158€, nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve, edhe pse aktivitetet e subvencionuara sipas marrëveshjeve duhej të kishin përfunduar kohë më parë.

Kjo ishte si pasojë e menaxhimit jo të mirë të procesit të dhënies së subvencioneve si dhe mungesës së mekanizmave adekuat që do t'i kushtëzonte përfituesit që të raportojnë për projektet e subvencionuara.

Ndikimi

Numri i madh i projekteve të paarsyetuara bën të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë dhe vlera për para janë arritur. Mos arsyetimi dhe raportimi për projektet e subvencionuara, mund të dëmtojnë buxhetin e ministrisë dhe rrisin mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Pa rregullsi në menaxhimin e subvencioneve të dhëna për Federatat e Sporteve të Kosovës

Gjetja

Sipas memorandumeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet MKRS dhe federatave të sporteve të Kosovës përkatësisht pika 5.7 specifikon që federatat janë të obliguara që të raportojnë për çdo periudhë tremujore për shpenzimin e mjeteve sipas realizimit të aktiviteve sportive, para se MKRS t'i alokojë mjetet për tre mujorin e radhës. Tutje rregullorja Nr. 09/2015 për subvencionimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve përkatësisht neni 21 pika 1, përcakton se përfituesit e subvencioneve pas realizimit të projekteve janë të obliguar të bëjnë mbylljen e tyre. Ndërsa pika 2.2 specifikon se përfituesit duhet që shpenzimin e mjeteve të përfituara t'i arsyetojnë me dorëzimin e dëshmimeve të dokumentuara.

Bazuar në politikat programore të ministrisë dhe Ligjit për Sport ministria mbështet financiarisht çdo vit federatat sportive të Kosovës për realizimin e objektivave dhe synimeve të tyre. Në vitin 2020 ministria përmes memorandumëve të bashkëpunimit kishte mbështetur 39 Federata Sportive dhe Komitetin Olimpik të Kosovës. Lidhur me këto ne kemi vërejtur si në vijim:

- Në 10 pagesa në vlerë 287,658€, subvencionimi ishte bërë pas realizimit të aktivitetit për të cilat ende nuk ishte bërë mbyllja e avanseve përkatësisht arsyetimi i shpenzimeve;
- Në gjashtë (6) pagesa në vlerë 199,075€ ishin dhënë subvencionet edhe pse nuk ishin arsyetuar ende tërësisht subvencionet e kësteve paraparake. Ndërsa dy prej tyre i kishin mbështetur financiarisht jashtë memorandumit të bashkëpunimit pavarësisht asaj që ende nuk i kishin arsyetuar shpenzimet nga obligimet që rrjedhin nga memorandumet e bashkëpunimit. Këto ishin për Federatën e Skitarisë të përkrahur për Garën Ndërkombëtare "Dardania Cup" në vlerë 52,626€ dhe Federatën e Çiklizmit për blerjen e Bicikletave në vlerë 22,750€;
- Në katër (4) pagesa me vlerë 80,560€ ne kemi identifikuar mangësi tek arsyetimi i realizimit të subvencioneve. Prej tyre në dy (2) raste arsyetimi i shpenzimeve për tremujorin e dytë të vitit 2020 për Federatën e Karatesë dhe Federatën e Basketbollit ishte bërë me fatura të vitit 2019, kjo kishte ndodhur në mungesë të aktiviteteve në vitin 2020 dhe obligimeve të federatës të mbetura në vitin paraprak. Derisa të Federata e Basketbollit për mbylljen e TM4-2019 dhe Federata e Karatesë për mbylljen e TM2-2020, ne kemi identifikuar mangësi tek arsyetimi i shpenzimeve për shfrytëzimin e hoteleve, transportit ajror dhe tokësor dhe furnizimeve të veshmbathjeve për sportist, ngase mungonin listat e pjesëmarrësve për qëndrimet në hotel, emrat e shfrytëzuesve të transportit si dhe atyre që janë furnizuar me veshmbathje. Vlera e tyre ishte 29,300€.

Këto mangësi kishin ndodhur si rezultat i bartjes me vonesë të pagesave të kësteve nga MKRS për federata, monitorimit të dobët të menaxhimit të shpenzimeve të federatave nga MKRS, mos përcaktimit të saktë të obligimeve të ndërsjella në marrëveshje dhe si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia.

Ndikimi

Dhënia e subvencioneve duke mos i respektuar kriteret e përcaktuara në memorandumet e bashkëpunimit, vonesat si dhe mangësitë në mbylljen dhe arsyetimin e subvencioneve nga federatat, mund të ndikojë në mos arritjen e objektivave të Ministrisë duke rritur rrezikun që fondet të përdoren për qëllime tjera nga ato të planifikuara.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurohet se respektohen të gjitha kriteret e përcaktuara në memorandumin e bashkëfinancimit të Federatave dhe të përcaktohet mënyra e subvencionimit në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara nga federatat. Gjithashtu të siguroj se vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren para realizimit të projekteve duke përcaktuar edhe kthimin e mjeteve nga federatat për pjesën e mjeteve financiare të cilën nuk kanë arritur të arsyetojnë me dokumente, në përputhje me kërkesat e memorandumit dhe rregullores për subvencionim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Subvencionim i dyfishtë i OJQ-ve nga ministria për projektin e njëjtë****Gjetja**

Neni 10 i Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit public të OJQ-ve, përkatësisht pika 1.4 përcakton se për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale përkatësisht të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete. Me tej pika 2 specifikon se me qëllim të dëshimit për përmbushjen e kriterit në fjalë aplikuesi nënshkruan dhe dorëzon deklaratat përkatëse.

Gjatë testimit kemi identifikuar se dy OJQ, "Doku Fest" dhe Fondacioni "Lumbardhi" gjatë vitit 2020, kishin përfituar mjete financiare në vlerë prej 47,500€ nga dy departamente brenda ministrisë për të njëjtat projekte. Për vlerën 19,500€ të subvencionimit të dyfishtë, OJQ-të në dëshmitë e ofruara në dosjen e aplikimit nuk kishin prezantuar deklaratë të saktë mbi financimin e dyfishtë të mjeteve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta nga zyrtarët përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve e deri te realizimi i pagesave si dhe në mungesë të bashkëpunimit mes departamenteve brenda ministrisë.

Ndikimi

Mungesa e kontrolleve adekuate në vlerësim të aplikacioneve, ekzekutim të pagesave për dhënien e subvencioneve si dhe mos koordinimi dhe bashkëpunimi brenda departamenteve të ministrisë rrit rrezikun e dëmtimit të buxhetit të saj si pasojë e financimit të njëjtit projekt nga departamente të ndryshme brenda ministrisë.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të siguroj që secili vendim për subvencionim do të jetë konform kërkesave të rregullores. Për më tepër, ministri duhet të inicioj rishikimin e rasteve të përmendura më lartë për të parandaluar subvencionimin e dyfishtë për projektin e njëjtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B5 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë****Gjetja**

Sipas rregullores 5/2010 dhe hyrje në fuqi në gusht të 2020 të rregullores nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e zyrtarëve Publik respektivisht neni 4 përcakton se punëtorët janë të obliguar të punojnë 40 orë në javë.

Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr.06/39 i dt. 22.07.2015, 21 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrojtja civile" ishin caktuar në departamente të ndryshme të MKRS-së në veri të vendit. Për këta zyrtarë, MKRS-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi, siç janë: vijueshmëria në punë apo raporte për punën e kryer gjatë vitit 2020, për të konfirmuar vijueshmërinë në punë ku punëtorët janë të obliguar të punojnë 40 orë në javë. Shpenzimet e pagave gjatë vitit 2020 për të punësuarit e lartë cekur ishin 158,989€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e sfidave në akomodimin dhe strukturimin e qartë të stafit në njësitë ku është dashtë të sistemohen. Kjo çështje sipas ministrisë është ngritë edhe në organet qeveritare, por ende nuk është zgjidhur.

Ndikimi

Pagesat e pagave në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit, si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara në marrëveshje dhe mos integrim të këtij komunitetit në sistemin aktual.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta adresoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë, po përsëritet për vite me radhë dhe asnjë masë drejt zgjidhjes nuk është ndërmarrë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Kompensim i komisioneve të brendshme në kundërshtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Sipas neni 80 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, brenda orarit të punës nuk lejohet kompensimi shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari.

MKRS kishte anashkaluar kërkesat ligjore dhe kompensuar stafin e angazhuar në këshilla drejtuese dhe komisione të ndryshme. Vlera totale e këtyre kompensimeve ishte 56,575€ të cilat ishin paguar: 18,650€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe 37,925€ nga kategoria subvencione dhe transfere.

Shkaku i këtyre kompensimeve sipas menaxhmentit të MKRS-së ishte motivimi i stafit, pasi që në mungesë të kompensimit stafi hezitojnë të angazhohen në komisione të tilla. Për këtë çështje, menaxhmenti i MKRS kishte kërkuar edhe interpretim në MF.

Ndikimi

Pagesat për kompensimin e stafit për punë shtesë janë në kundërshtim me legjislacionin duke rezultuar me pagesa të parregullta.

Rekomandimi A5

Ministri duhet t'i rishikoj rastet e mësipërme dhe t'i ndalojë pagesat pa një bazë të qartë ligjore, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të iniciojë zhvillimin e një politike të re rreth funksionimit të këshillave drejtuese dhe komisioneve duke specifikuar në mënyrë të qartë udhëzimet rreth angazhimit, punës dhe kompensimit të anëtarëve të këshillave e dhe komisioneve të ndryshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22 parasheh që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimi të blerjeve bëhet raporti i pranimi, si dhe pranohet fatura.

Në tri (3) mostra të testuara për mallra dhe shërbime në vlerë 34,974€, kemi vërejtur se në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të procedurave ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë me vonesa në realizimin e pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për periudhat vijuese.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ishte 1,872,256€, prej tyre ishin shpenzuar 1,571,340€. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, pajisje të IT-së, derivate, shpenzime të qirasë, shërbime kontraktuese, shërbime komunale etj. Ne kemi testuar 17 mostra për teste substanciale në vlerë 106,059€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë me procedurat.

Çështja A7 - Vonesë në njoftimin për nënshkrim të kontratës

Gjetja Sipas nenit 41 të LPP-së përcaktohet se autoriteti kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, duhet të përgatisë dhe publikojë njoftimin për dhënien e kontratës.

Gjatë auditimi kemi vërejtur që MKRS ishte vonuar për të publikuar njoftimin për dhënie të kontratës. Ministria kishte nënshkruara kontratat, mirëpo vonesat në njoftimin për dhënien e kontratës nga ministria ishin 38 përkatësisht 121 ditë vonesë: Këto raste janë:

- Te kontrata "Shërbime Përkthimi dhe Lekturimi" në vlerë deri në 10,000€; dhe
- Te kontrata "Shërbime Audio Incizime live në studio për Ansamblin Shota" në vlerë 8,800€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se MKRS kishte punuar me staf të reduktuar dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri te vonesat e publikimit të këtij njoftimi.

Ndikimi Vonesat për njoftimin për nënshkrimin e kontratës, cenon transparencën ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitet dhe KRPP-së të cilët duhet të kenë informata të sakta brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të sigurojë kontrolle në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për nënshkrimin e kontratës sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mungesa e përcaktimit të menaxherit të kontratës

Gjetja Sipas UOPP neni 61 menaxhimi i kontratës, paragrafi 61.4 kërkon caktimin e menaxherit të kontratës për kontratat e udhëhequra sipas procedurave të prokurimit të përcaktuara me LPP.

Ne kemi identifikuar se Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) në tre raste nuk kishte caktuar menaxherët e kontratave. Këto raste janë për kontratat: 1. "Furnizim me mjete pune" vlera 3,360€; 2. "Furnizime dhe Shërbime pastrimi për 4 arkiva ndër komunale" në vlerë 4,425€ dhe 3. "Furnizim me kutia arkivore vlera 8,724€".

Kjo ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur profesional nga ana e zyrtarëve përgjegjës në respektimin e kriterëve të përcaktuara në ligj.

Ndikimi

Mungesa e menaxherit të kontratës rrit rrezikun që furnizimet/shërbimet mos të jenë në përputhje me kërkesën sipas AK.

Rekomandimi A8

Ministri në koordinim me Kryeshefin duhet të sigurojnë që për secilën procedurë të prokurimit të përcaktoj menaxherin e kontratës në përputhje me kërkesat e ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 12,251,204€. Prej tyre në vitin 2020 ishin shpenzuar 11,157,716€. Ministria mbështetë financimin e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore. Në këtë fushë kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 3,482,145€, dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë. Auditimi ynë ka identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A9 - Vonesa në përmbylljen e projekteve filmike

Gjetja

Neni 19 i rregullores 07/2016 për subvencionimin e projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës, pika 2.1 përcakton se afatet kohore për fillimin e xhirimeve nuk mund të jenë më gjatë se gjashtë muaj dhe kohëzgjatja e realizmit të projektit filmik që rezulton me kopjen e parë të filmit nuk mund të jetë më gjatë se 36 muaj, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Për projektin e filmit "Skype" të financuar nga Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) në vlerë 120,000€, kemi identifikuar vonesa më shumë se tre vite në realizmin e projektit filmik. Kontrata ishte nënshkruar në dhjetor të vitit 2016 dhe ishte dashur të përfundojë më së largu në fillim të vitit 2018, ndërsa ky projekt ende nuk kishte përfunduar. Vlen të theksohet se QKK-ja kishte bërë dy herë vazhdimin e kontratës me kërkesë të projektuesit.

Për më tepër nga lista e projekteve filmike të financuara nga QKK-ja, kishte vonesa në mbylljen e projekteve filmike nga një (1) deri tetë (8) vite. Për më tepër, ne kemi identifikuar se në 4 raste produksionet filmike kishin përfunduar realizimin e filmit ndërsa ende nuk kishin bërë arsyetimin e mjeteve financiare të marra nga ministria. Vlera e obligimeve të kontraktuara të krijuara nga QKK deri në fund të 2020 kap totalin prej 2,414,032€.

Sipas Qendrës Kinematografike të Kosovës kjo ka ndodhur si rezultat i vështirësive të përfituesit në sigurimin e pjesës së mbetur të financimit vetjak për përmbushjen e projektit filmik, si dhe neglizhencës së projektuesve në përmbushjen e obligimeve kontraktuale.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve filmike ndikojnë që MKRS të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe në mungesë të fondeve buxhetore për vitet pasuese, projektet e filluara mund të mos përfundohen edhe një kohë të gjatë, me ndikim në mos arritjen e objektivave vjetore të QKK-së.

Rekomandimi A9

Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet filmike të subvencionuara realizohen dhe arsyetohen në përputhje me kushtet e kontratës dhe kriteret e përcaktuara në rregullore. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve apo vonesave në realizim të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me kontratat përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2020 ishte 17,478,278€, ndërsa ishin shpenzuar 7,539,522€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore etj. Ne kemi testuar 70 mostra për teste substancile në vlerë 3,028,160€ dhe pesë teste të pajtueshmërisë me procedura.

Çështja B6 - Vonesat në realizimin e punimeve

Gjetja

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet MKRS-së dhe operatorëve ekonomik për realizimin e projekteve kapitale përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve sipas kontratës.

Në tri raste, kemi identifikuar se punimet nuk ishin realizuar siç parashihej me kontratë, pra kishte ngecje në këto projekte pasi që punimet duhet të përfundonin në vitin 2019, respektivisht në vitin 2020, por që nuk ishin përfunduar. Këto janë identifikuar si në vijim:

- Stadiumi i qytetit Gjilan vlere e kontratës 3,121.346€, duhej të përfundonte me 23.10.2020, ndërsa deri në fund të vitit 2020 ishin realizuar vetëm 54.29% e punëve të kryera. Më tutje, në muajin e tetor 2020 ishte bërë amandamenti i kontratës ku janë paraparë ndryshime në punët që duhet kryer pa paraparë kohën e kryerjes dhe aspektin financiar të ndryshimeve nga kontrata bazë;
- Palestra Sportive Skënderaj - vlere e kontratës 651,965€, e nënshkruar me datën 06.10.2017, duhej të përfundonte me datën 06.10.2019, por ende nuk kishte përfunduar.
- Qendra Kulturore në Han të Elezit - vlere e kontratës 409,985€ e nënshkruar me datën 28.08.2019 përfundimi i punëve do të duhej të bëhej brenda 120 ditëve kalendarike, ndërsa kishte përfunduar me datën 24.09.2020.

Arsyeja e vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte planifikimi jo i mirë i tyre si dhe mungesa e buxhetit.

Ndikimi

Vonesat në përfundimin e projekteve kapitale ndikojnë që MKRS të mos arrijë objektivat e përcaktuara si dhe mungesa e fondeve buxhetore për vitet pasuese, mund të ndikoj që projektet e filluara të mos përfundohen edhe për një kohë të gjatë.

Rekomandimi B6

Ministri duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave, si dhe të rishikoj disponibilitetin e fondeve kundrejt punimeve të kontraktuara. Në të kundërtën, nuk duhet të nënshkruhen kontrata pa sigurimin paraprak të fondeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështja A10 - Mos respektim i kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së operatorëve ekonomik

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 05/L-092 për Prokurimin Publik, neni 59 paragrafi 4. thekson se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. - Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme dhe aneksi 7 i cili është obligativ kërkon që të plotësohet dhe t'i bashkëngjiten dëshmitë e kërkuara për pajisjet dhe mekanizmin e obligueshëm.

- Te kontrata “Qendra Nacionale e Xhudos” me vlerë 298,342€, ministria kishte shpërblyer me kontratë OE i cili nuk kishte bashkëngjitur në dosjen e tenderit dëshminë për posedimin e një pajisje të domosdoshme sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Kjo makinë ishte ofruar nga operatori ekonomik, pas kërkesës së ministrisë për informata sqaruese, mirëpo kërkesa për sqarime ishte në kundërshtim me pikën 39 të udhëzuesit të prokurimit publik, që përcakton se për cilat kërkesa mund të kërkohej sqarime shtesë;
- Te kontrata “Furnizim me pajisje të TI” në vlerë 23,401€ aktiviteti i realizuar nga ASHAK, ishte shpërblyer me kontratë OE i cili për tre pozicione nuk i kishte ofruar specifikimet ashtu siç ishin përcaktuar në dosjen e tenderit. Vlen të ceket se nga katër (4) ofertuesit sa kishin konkurruar në këtë aktivitet prokurimi, vetëm OE i katërt apo OE me çmimin më të lartë i kishte plotësuar në tërësi specifikimet teknike të kërkuara në dosje, mirëpo ishte eliminuar për shkak të çmimit më të lartë sesa vlera që ishte e parashikuar nga ASHAK.

Për kontratën “Qendra Nacionale e Xhudos”, sipas ministrisë kjo kishte ndodhur si rezultat i nevojës që ky projekt të përfundojë më shpejtë për përmbushjen e nevojave të federatës së Xhudos. Ndërsa, te kontrata e ASHAK për “Furnizim me pajisje të TI” arsye ishte mungesa e buxhetit pasi që kërkesat e vendosura në dosje tejkalonin buxhetin e planifikuar.

Ndikimi

Nënshkrimi i kontratave pa u përmbushur kriteret e kërkuara në dosje të tenderit dhe vendosja e specifikave në mungesë të buxhetit për blerjen e tyre, përveç që është në kundërshtim me ligjin mund të ndikoj në cilësi e dobët të mallrave të kontraktuara, favorizime si dhe ndikon në zvogëlimin e besueshmërisë së procesit.

Rekomandimi A10

Ministri dhe Kryeshefi i ASHAK-ut duhet të sigurojnë se nënshkrimi i kontratave bëhet vetëm pasi janë respektuar plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe se para fillimit të procesit të prokurimit të sigurohet se fondet e buxhetuara janë të mjaftueshme për mbylljen e aktiviteteve të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Sipas PFV-ve vlera neto e pasurisë kapitale me 31 dhjetor 2020, ishte 48,268,142€, vlera neto e pasurive jo kapitale ishte 210,295€ dhe vlera e stoqeve 27,759€. Për auditimin e vitit 2020 ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë totale 3,055,886€.

Çështja B7 - Mos-harmonizimi i Raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë si dhe mungesa e formimit të komisionit të vlerësimit të pasurisë

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.3. thotë se Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.”, si dhe neni 20 përcakton se “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës.” Me tutje, sipas nenit 21, Komisioni për Vlerësim e Pasurisë jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga ZKA i organizatës buxhetore.

Në MKRS është bërë inventarizimi i pasurisë për vitin 2020, komisioni ka përpiluar një raport gjithëpërfshirës mirëpo nuk ka bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël. Për më tej, ZKA nuk kishte formuar komisionin për vlerësimin e pasurisë për vitin 2020.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive.

Ndikimi Mos harmonizimi i regjistrat të inventarizimit me regjistrat e pasurive jo financiare pamundëson konfirmimin e ekzistencës së pasurive në ditën e regjistrimit, dhe rrjedhimisht prezantimin jo të drejt të pasurive në PVF. Ndërsa, në mungesë të vlerësimit të pasurisë, ministria nuk ka një pasqyrë të qartë se cilat pasuri janë të përdorshme.

Rekomandimi B7 Ministri duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të kryej të gjitha regjistrimet e fundvitit dhe të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të sqaroj të gjitha diferencat. Dhe vetëm pas harmonizimit të regjistrave, ta paraqes gjendjen e pasurive në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹³	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	44,176,110.00	37,030,253.92	25,583,740.11	30,917,975.79	29,952,620.62
Grante Qeveritare - Buxheti	32,620,720.00	27,523,901.66	23,555,254.35	23,956,313.35	27,520,149.19
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	24,752.67	15,373.29	7,282.52	7,947.16
Të hyrat vetanake	55,390.00	55,390.00	10,378.22	10,590.06	23,166.09
Te hyrat nga AKP-ja	11,500,000.00	9,230,121.97	1,988,891.67	6,819,537.29	2,373,307.69
Donacionet vendore	0.00	4,407.04	509.43	14,443.43	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	191,680.58	13,333.15	109,809.14	28,050.49

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 7,145,856€. Kjo ulje është si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar 5,629,719€ ndërsa me vendime të qeverisë 1,516,137€.

Në vitin 2020 ministria ka shpenzuar 69 % të buxhetit përfundimtar të vitit 2020 ose 25,583,740€, me një ulje prej 5% në krahasim me realizimin e vitit 2019. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	44,176,110.00	37,030,253.92	25,583,740.11	30,917,975.79	29,952,620.62
Pagat dhe mëditjet	4,965,787.00	5,170,706.47	5,074,725.22	5,052,779.97	4,504,695.91
Mallrat dhe shërbimet	2,176,437.00	1,872,255.64	1,571,340.02	1,822,793.42	1,703,541.72
Komunalitë	404,908.00	257,809.81	240,436.43	297,455.71	317,330.35
Subvencionet dhe transferet	9,201,550.00	12,251,204.45	11,157,716.36	11,432,738.66	10,734,320.33
Investimet Kapitale	27,427,428.00	17,478,277.55	7,539,522.08	12,312,208.03	12,692,732.31

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 204,920€, sipas vendimit të Qeverisë Nr.09/50 të datës 21.12.2020 për harmonizimin e pagave në vlerë 109,278€ si dhe buxheti i bartur i granteve nga Fondi Global në vlerë 95,642€. Shpenzimet ishin 98% e buxhetit;

- Buxheti për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar, kishte ulje për 304,181€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për vlerën 304,500€ ndërsa me vendim të qeverisë kishte një rritje të vogël për 319€. Në këtë kategori ishin shpenzuar 84%;


Buxheti i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 147,098€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për vlerën 129,089€ ndërsa me vendime të qeverisë Nr.09/50 të datës 21.12.2020 për vlerën 18,009€. Shpenzimi ishte 93% e buxhetit;

- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 3,049,654€. Fillimisht buxheti kishte rritje si rezultat i rishikimit buxhetor në vlerë 50,000€, si dhe programit për rimëkëmbje ekonomike sipas vendimit të qeverisë në vlerë 2,500,000€. Pastaj me lëvizjet tjera përmes vendimeve të qeverisë, kishte rezultuar me rritje për vlerën 499,654€. Shpenzimet ishin 91% e buxhetit;


- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 9,949,150€. Me rishikim ishte zvogëluar për vlerën 5,246,130, ndërsa me vendime të qeverisë, Nr.01/46 të datës 25.11.2020 dhe Nr.09/50 i datës 21.12.2020 ishte zvogëluar për vlerën 4,703,020€. Shpenzimi i buxhetit në këtë fushë ishte 43%.

Shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID 19 nga ministria ishin në vlerë prej 2,459,797€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga MKRS në vitin 2020 ishin 27,680€. Këto të hyra janë realizuar nga Arkiva Shtetërore 14,221€, nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor Prizreni 3,584€, Biblioteka Kombëtare e Kosovës 1,288€, Teatri Kombëtar i Kosovës 2,962€ Kinematografia e Kosovës 5,150€ si dhe të hyrat nga viti i kaluar 475€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e biletave për shfaqje, koncerte, pëlqime etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	25,249.00	21,007.00	27,680.33	64,870.91	767,828.00
Të hyrat jo tatimore	25,249.00	21,007.00	27,204.97	56,673.09	59,662.64
Të hyrat tjera	0.00	0.00	475.36	8,197.82	708,165.36

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka rezultuar në 16 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020 tetë (8) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandime ishte në proces dhe në shtatë (7) rekomandime nuk ka filluar zbatimin, (shih Grafikun 4). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate	Përveç keqklasifikimeve të pagesave përmes vendimeve gjyqesore të shkaktuara nga Thesari në mungesë të buxhetit dhe pagesave të ekzekutuara, ne nuk kemi identifikuar keqklasifikime të pagesave të shkaktuara nga ministria. Sa i perket punes jashte orarit MKRS ka nderrmare hapa ne kete drejtim ku pas rekomandimit te dhene nga ZKA ka filluar te kryej pagesa kategoria Paga dhe meditje.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Pagat dhe meditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta adresoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë, po përsëritet për vite me radhë dhe asnjë masë drejt zgjidhjes nuk është ndërmarrë.	Sa i përket zyrtarëve të Mbrojtjes Civile ne MKRS dhe ASHAK , gjendja nuk ka ndryshuar, pra vazhdon te jete e njëjtë si vitet e mëparshme.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pagat dhe meditjet	Ministri duhet të sigurojë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në Ministri (pozita të rregullta), të sigurojë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe meditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, duke kaluar përmes sistemit të pagave.	Nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore MKRS jemi njoftuar me shkrim qe pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik me date 14.07.2020, të angazhuarit me Kontrata me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta kanë vazhduar deri me	I zbatuar

			përfundimin e kontratës valide që e kanë pasur dhe më pastaj janë ndërprerë këto kontrata. Aktualisht përmes këtyre kontratave nuk kemi asnjë zyrtarë të angazhuar, pasi kontratat e tyre kanë skaduar të gjitha. Po ashtu konfirmim dhe deshmi kemi marr edhe nga Drejtori i prokurimit ku Zyra e Prokurimit ka zhvilluar procedurën e negociuar të prokurimit dhe ka zbatuar dokumentet e nevojshme si deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve dhe ka njoftuar KRRPP-në ashtu siç e kërkon dispozita ligjore.	
--	--	--	---	--

4.	Pagat dhe mëditjet	Ministri respektivisht, Kryeshefi i ASHAK-ut duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale të stafit, në mënyrë që të zbatohen kërkesat ligjore sa i përket ndaljes së tatimit në burim për të punësuarit me kontratë për shërbime të veçanta, dhe rastet e tilla të mos përsëriten.	Rekomandimi i dhënë për tatimin në burim për zyrrate me MSHV në ASHAK është zbatuar. Pagesat për kontribute dhe tatim kanë filluar të bëhen me datën 29.07.2020. Gjithashtu nga ASHAK jemi njoftuar se janë paguar të gjitha faturat për kontribute dhe tatim për vitin 2019 ku ka qenë rekomandim i ZKA. Të gjitha faturat janë të paguara për vitin 2019 dhe 2020.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet, që personat që i kanë arsyetuar avanset që nga viti 2010 deri në fund të vitit 2019, t'i kryejnë barazimet me shërbimin e financave dhe të kontabilitetit. Në rast se nuk i posedojnë dëshmitë e duhura për arsyetimin e avanseve, atëherë shumat e tërhequra për këtë qëllim, të kthehen në tërësi brenda një periudhe tremujore. Në të kundërtën, të ushtrojë padi gjyqësore kundër të gjithë personave për kthimin e këtyre parave. Gjithashtu, ministri duhet të vendos kontrole strikte që avanset e dhëna në të ardhmen, të arsyetohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Gjendja me avanse për udhëtime zyrtare në MKRS vazhdon të jetë e njëjtë sikurse vitet paraprake.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të forcoj kontrollet në fushën e prokurimit, për të siguruar se zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit të cilat nuk janë të përfshira në planin final të prokurimit, do të bëhet vetëm pas njoftimit të AQP-së. Po ashtu, zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratës, në mënyrë që të mos krijohen obligime pa fonde të mjaftueshme.	Gjatë testimit të mostrave të auditimit, ne nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me kontratat përkatëse.	Ende ministria nuk kishte ndërmarrë masat e nevojshme për të adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin


8.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se mbështetja financiare e OJQ-ve do të bëhet përmes thirrjes publike, dhe kërkesat e rregullores Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve do të zbatohen me konsistencë.	Për vitin 2020 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se nënshkrimi i kontratave nuk do të bëhet pa buxhet të planifikuar, në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar. Në rast të paraqitjes në punëve të paplanifikuara, të zbatohen rregullat e prokurimit dhe të sigurohen mjetet e nevojshme para nënshkrimit të aneks kontratave.	Edhe në vitin 2020 janë identifikuar pa rregullësi të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se para realizimit të kontratës të kërkohej nga kompania ndërkombëtare që të themeloj përfaqësuesin fiskal në Kosovë, për të marrë siguri se kompania po i përmbush obligimet ligjore ndaj ATK-së. Më tej, për rastin konkret të kërkojë nga kompania fituese ndryshim të kontratës për t'i përmbushur kërkesat ligjore të ATK-së.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë testimit të procedurave të prokurimit.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Ministri duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për të siguruar kompetencën profesionale të stafit në mënyrë që të zbatohen kërkesat ligjore, lidhur me pagesën e paradhënies dhe realizimit të pagesave vetëm pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara me Ligjin e Buxhetit.	Gjatë testimeve kemi vërejtur se paradhënia është bërë sipas Ligjit të Buxhetit	I zbatuar
12.	Çështjet e përbashkëta	Ministri duhet të marrë veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e formimit të komisioneve dhe caktimit të menaxherëve të kontratave, të merren parasysh parimet për ndarjen e detyrave në mënyrë që zyrtarët të cilët caktohen në komisionet e vlerësimit, të mos caktohen edhe menaxherë të kontratave.	Gjatë testeve tona nuk kemi hasur në çështje të tilla	I zbatuar

13.	Çështjet e përbashkëta	Ministri duhet të sigurojë rishikim në lidhje me rastet në fjalë, për të vlerësuar ligjshmërinë e këtyre kontratave si dhe për të vlerësuar nëse shërbimet e kontraktuara janë ekonomike dhe sigurojnë vlerën për parën e shpenzuar, dhe njëherësh të sigurohet që zyrtarët e MKRS të mos nënshkruajnë kontrata në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.	Sa i përket rekomandimit të dhënë në lidhje me Mediat- zyra e prokurimit kishte lidhur marrëveshje me portalet dhe agjencitë e lajmeve më të mëdha nacionale si: Ekonomia Online, Kosova Press, Gazeta Blic, Gazeta Express, Indeks online dhe Insajderi, duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.	I zbatuar
14.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë, në mënyrë që për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komunat.	Edhe në vitin 2020 janë identifikuar mangësitë e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
15.	Pasuritë	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Njëherësh të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektoj ndryshimet eventuale në PVF.	MKRS nuk i kishte ndërmarr hapat e nevojshëm për të siguruar se regjistri i pasurive është i plotë dhe i sakt për shkak se gjatë testimit kemi vërejtur se ekzistojnë pasuri të cilat nuk janë regjistruar në regjistra.	Nuk ka filluar zbatimin
16.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara protokolohen dhe evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit (përveç atyre që janë afat) të evitohet.	Gjatë testimit të mostrave kemi hasur që në disa raste faturat e pranuar në MKRS nuk ishin protokoluara. Përveç kësaj kemi hasur edhe parregullesitë rreth raportimit të obligimeve të cilat janë shpalosur në raport.	Nuk ka filluar zbatimin

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që me rastin e përgatitjes së PVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për obligimet e papaguara.
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë një bashkëpunim efektiv me Ministrinë e Financave për të siguruar që pagesat realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas kërkesave të rregullores në përputhje me planin kontabël.
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit.
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë veprimet për të gjitha avanset e pa arsyetura që nga viti 2010 deri në fund të vitit 2019, t'i arsyetojnë dhe mbyllin ato me zyrën e financave. Në rast se nuk i posedojnë dëshmitë e duhura për arsyetimin e tyre, atëherë të kthehen paratë në buxhetin e ministrisë. Në të kundërtën, të ushtrojë padi gjyqësore kundër të gjithë personave për kthimin e këtyre parave.
6.	Baza për konkluzion	Ministri të siguroj që janë vendosur kontrole adekuate të cilat konfirmojnë saktësinë dhe rregullsinë e implementimit të projekteve në mënyrë që çdo projekt të implementohet sipas kushteve të kontratës. Njëherit të siguroj që kërkesat ligjore lidhur me aneks kontratat aplikohen në mënyrë strikte.
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.
8.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurohet se respektohen të gjitha kriteret e përcaktuara në memorandumun e bashkëfinancimit të Federatave dhe të përcaktohet mënyra e subvencionimit në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara nga federatat. Gjithashtu të siguroj se vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren para realizimit të projekteve duke përcaktuar edhe kthimin e mjeteve nga federatat për pjesën e mjeteve financiare të cilën nuk kanë arritur të arsyetojnë me dokumente, në përputhje me kërkesat e memorandumit dhe rregullores për subvencionim.
9.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që secili vendim për subvencionim do të jetë konform kërkesave të rregullores. Për më tepër, ministri duhet të inicioj rishikimin e rasteve të përmendura më lartë për të parandaluar subvencionimin e dyfishtë për projektin e njëjtë.
10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta adresoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë, po përsëritet për vite me radhë dhe asnjë masë drejt zgjidhjes nuk është ndërmarrë.
11.	Baza për konkluzion	Ministri duhet t'i rishikoj rastet e mësipërme dhe t'i ndalojë pagesat pa një bazë të qartë ligjore, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të iniciojë zhvillimin e një politike të re rreth funksionimit të këshillave drejtuese dhe komisioneve duke specifikuar në mënyrë të qartë udhëzimet rreth angazhimit, punës dhe kompensimit të anëtarëve të këshillave e dhe komisioneve të ndryshme.

12.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.
13.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurojë kontrolle në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për nënshkrimin e kontratës sipas kërkesave ligjore.
14.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri në koordinim me Kryeshefin duhet të sigurojnë që për secilën procedurë të prokurimit të përcaktoj menaxherin e kontratës në përputhje me kërkesat e ligjore.
15.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet filmike të subvencionuara realizohen dhe arsyetohen në përputhje me kushtet e kontratës dhe kriterëve të përcaktuara në rregullore. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve apo vonesave në realizim të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me kontratat përkatëse.
16.	Investimet kapitale	Ministri duhet të bëj një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave, si dhe të rishikoj disponibilitetin e fondeve kundrejt punimeve të kontraktuara. Në të kundërtën, nuk duhet të nënshkruhen kontrata pa sigurimin paraprak të fondeve.
17.	Çështjet e përbashkëta	Ministri dhe Kryeshefi i ASHAK-ut duhet të sigurojnë se nënshkrimi i kontratave bëhet vetëm pasi janë respektuar plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe se para fillimit të procesit të prokurimit të sigurohet se fondet e buxhetuara janë të mjaftueshme për mbylljen e aktiviteteve të prokurimit.
18.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të kryej të gjitha regjistrimet e fundvitit dhe të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të sqaroj të gjitha diferencat. Dhe vetëm pas harmonizimit të regjistrave, ta paraqes gjendjen e pasurive në PVF.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Udhëheqës i Auditimit



Albesa Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Burbuqe Idrizi, Anëtare e ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE / DATUM	ORGANIZATON	NUMER	STRANICA
03	47	1166	1



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Министерство Кulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	2349/2021-2
Data / Datum	12.07.2021
Signature	Adonij

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport – Ministry for Culture, Youth and Sport

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të pasqyrave financiare vjetore të MKRS-së "draft-raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të ministrisë së kulturës, rinisë dhe sporteve për vitin 2020", dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 12.07.2021, Prishtinë

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit "Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të ministrisë së kulturës, rinisë dhe sporteve për vitin 2020", (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ibër ALAJ, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm/MKRS

Adresa: Rr. "Nënë Tereza" - 10000 Prishtinë-Kosovë
 Telefon: +38138211451, cel: +37744 153 001
<http://www.mkrs-ks.org>, iber.alaj@ks-gov.net

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁴ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹⁵ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. Kulla e Haxhe Mustafe Lajci 5,865.99€; 2. Renovimi dhe Funksionimi i Shtëpisë së Kullës Isa Kastrati dhe Shtëpive Komunitare në Kamenicë 55,243.50€; 3. Palestra e Sportit Viti 87,500.00€; 4. Renovimi i Palestrave Ekzistuese Sportive në Qendrat Regjionale 51,782.50€; 5. Ndërtimi i kullës Haxhë Mustafë Lajçi 18,250.00 €; 6. Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Gjilan 181,858.50€; 7. Renovimi i ndërtesës ASHAK (avans) 17,245.00€; 8. Renovimi i ndërtesës ASHAK (avans) 34,490.50€; 9. Serveri ASHAK 2,860.00€ 10. Vendime gjyqësore 100,000.00€; 11. Vendime gjyqësore 100,000.00€; 12. Vendime gjyqësore 100,000.00€; 13. Vendime gjyqësore 50,000.00€; 14. Vendime gjyqësore 43,087.29€; 15. Vendime gjyqësore 39,477.20€; 16. Vendime gjyqësore 19,692.37€. 1. Kompleksi Rexhep Malaj 15,829€. 1. Paisjet tjera 8,447€; 2. Blerja e kompjuterëve 13,485€; 3. "Paisje tjera (laborator për restaurim të dokumenteve)" në vlerë prej 2,560€; Kompjuter në vlerë prej 20,541€. 1. "Mobilje" në vlerë prej 14,828€ .
- ⁶ 1. Inna Nails, 2. Sensibilizimi i të Rinjëve dhe Parandalimi i Trafikimit, 3. Parandalimi ekstremizmit dhe radikalizim fetar, 4. Vajza kontribut dhënës në siguri dhe 5. Subvencionimi i filmit Njëri me Këmishë;
- ⁷ 1. Jo Simfonia e 5-të po e 9-të, 2. Sherbime shtypi; 3. Palestra e Sporteve Loxhë Pejë, dhe 4,5,6,7 ne kater raste derivate te veturave; 1. Fatura në vlerë 975€ Shërbime Shtypi; për 2. Pagesa në total prej 958.90€ për furnizim për zyre në të cilën përfshihen tri fatura dhe 3. Fatura në vlerë 576,000€ për Projektin Studimin e Fizibilitetit për Stadiumin Kombëtar të Futbollit në Drenas.
- ⁸ 1. Ta njohim trashëgiminë kulturore 4,500€; 2. Tradita shqiptare me orkestrim dhe stile unike 5,000€; 3. Festivali Ndërkombëtar i Filmit-Dokufest 10,000€; 4. Projekti: Leximi na bashkon 2,000€; 5. Program trajnimi profesional për të rinjtë e papunë 14,000€; 6. Program trajnimi profesional për të rinjtë e papunë 14,000€; 7. F. Atletikes- TM1-2020; 8. F. Bodybuildingut- TM1-2020; 9. F. Kikboksit- TM1-2020; 10. F. Notit- TM4-2019; 11. F. Skitarise- TM2-2020; 12. F. Hendbollit- TM3-2020; 13. F. Xhudo- TM3-2020; 14. F. Hendbollit- TM2-2020; 15. F. Notit- TM1-2020 dhe 16. F. Teakwondos- TM1-2020.
- ⁹ 1. F. Atletikes- TM1-2020; 2. F. Bodybuildingut- TM1-2020; 3. F. Kikboksit- TM1-2020; 4. F. Notit- TM4-2019; 5. F. Skitarise- TM2-2020; 6. F. Hendbollit- TM3-2020; 7. F. Xhudo- TM3-2020; 8. F. Hendbollit- TM2-2020; 9. F. Notit- TM1-2020 dhe 10. F. Teakwondos- TM1-2020; Federat Futbollit, F. Notit, F. Skitarisë, F. Teakwondos; F. Çiklizmit
- ¹⁰ 1. "Mobilje" vlerë 1,725€; 2. "Mirëmbajtje TI" vlerë 18,199€; 3. "Furnizim me mobilje" vlera 15,049.96€.
- ¹¹ 1. Furnizim me mjete pune vlera 3,360€; 2. Furnizime dhe shërbime pastrimi për 4 arkiva ndër komunal në vlerë 4,425€ dhe 3. Furnizim me kutia arkivore vlera 8,724€.
- ¹² 1. "Në kërkim të Venerës", "Homo", "Kosova dhe Hebrejtë", "Zgjoi" dhe "Martesa"
- ¹³ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁴ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁵ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.